



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHMË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Tiranë, më 28.05.2021

Lënda: Kthim përgjigjeje

Drejtuar: Av. Dorian Matlija, Drejtor Ekzekutiv, Qendra "Res Publica"

I nderuar Z. Matlija

Në përgjigje të kërkesës suaj, Ju informojmë se:

1. A është ende në fuqi akti normativ i datës 15.03.2020 që ndalon grumbullimet, tubimet, koncertet, organizimet etj?

-Akti Normativ i datës 15.03.2020 është në fuqi.

2. A ka marrë leje te Policia e Shtetit Kryeministri Edi Rama për të zhvilluar mbledhjen e mijëra qytetarëve në sheshin "Skënderbej", pas rizgjedhjes së tij si Kryeministër tre mandate radhazi?

-Në lidhje me aktivitetin e datës 27.04.2021, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, në zbatim të Ligjit për Policinë e Shtetit dhe të procedurave standarde të punës, si dhe në kuadër të bashkëpunimit institucional, ka marrë njoftim nga Garda e Republikës se Personalitetet e Larta të Shtetit do të marrin pjesë në aktivitetin e organizuar nga Partia Socialiste të sheshi "Skënderbej".

3. A lejohen protestat tashmë që rastet e infektimit me Covid-19 janë ulur?

Policia e Shtetit, në lidhje me tubimet dhe grumbullimet, zbaton kërkesat e Ligjit për Tubimet nr. 8773, datë 23.04.2001, ligjin për Policinë e Shtetit nr. 108/2014 i ndryshuar, si dhe Aktet Normative të nxjerra për parandalimin e përhapjes së COVID-19.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

Koordinatori për të Drejtën për Informim

Gentian Mullaj